



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Beqir Kalludra, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Zyhdi Haziri, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurës L.Z. nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPRK, duke vendosur sipas ankesës së të dëmtuarës E.T, të datës 14 tetor 2020, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.4017/2019, të datës 15 shtator 2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 8 shkurt 2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të dëmtuarës E.T, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4017/2019, i datës 15 shtator 2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin e lartcekur, përkatësisht me aktgjykimin e ankimuar, të pandehurën L.Z e ka shpallur fajtores për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK (pika I e dispozitivit) dhe veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPRK (pika II e dispozitivit). Për shkak të veprave penale sipas pikave I dhe II të dispozitivit të aktgjyqimit të ankimuar, ndaj të pandehurës L.Z është shqiptuar vërejtje gjyqësore, ku me këtë rast të pandehurës i është bërë me dije se ka kryer veprat penale të cilat janë të sanksionuara me nenet 321 dhe 185 të KPRK dhe se për këto vepra penale janë paraparë sanksione penale.

Është detyruar e pandehura L.Z që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzet Euro) dhe në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumën prej 20 € (njëzet Euro), të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

E dëmtuara E.T nga Obiliqi, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur e dëmtuara E.T, ku nga përmbajtja e ankesës shihet se e njëjta është paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të vendimit mbi dënimin, mirëpo në të nuk është paraqitur ndonjë propozim konkret, duke shtuar se e kundërshton aktgjykimin e lartcekur.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.1034//2020, të datës 12 janar 2021, ka propozuar që të aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e të dëmtuarës, ndërsa të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar, në atë mënyrë që ndaj të pandehurës për shkak të veprës penale sipas pikës II të dispozitivit të shqiptohet një dënim më i ashpër, ndërsa për veprën penale sipas pikës I të dispozitivit të hudhet poshtë si e palejueshme.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

- ankesa është e pabazuar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljeve të ligjit penal dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal në dëm të të pandehurës L.Z.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e të dëmtuarës janë të pabazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë, në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurës L.Z kishte marrë për bazë si rrethana lehtësuese se e pandehura e kishte pranuar fajësinë, se ka pasur sjellje të mirë gjatë seancës, është penduar për atë që e ka bërë, ndërsa nuk gjeti asnjë rrethanë rënduese. Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë dhe duke i pasur në konsideratë edhe rrethanat tjera të rastit konkret, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se vërejtja gjyqësore e shqiptuar ndaj të pandehurës L.Z është sanksion i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me peshën e veprës penale, me cilësitë personale të të njëjtës, me rrethanat nën të cilat janë kryer veprat penale, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale

të saj. Gjithashtu, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës është i bindur se me këtë sanksion penal të shqiptuar do të arrihet qëllimi i parashikuar me nenin 38 të KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e saj; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet ankimore, pasi që duke u bazuar në nenin 381 paragrafi 3 të KPP, pala e dëmtuar nuk ka të drejtë që të paraqes ankesë përkitazi me këtë bazë ankimore.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lart e në bazë të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1021/2020, më datën 8 shkurt 2021

Bashkëpunëtorja profesionale,
Kimete Veseli

Anëtarët e kolegjit:
Afrim Shala

Kryetar i kolegjit,
Beqir Kalludra

Zyhdi Haziri